



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

20254  
Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 27.10.2020

**URDHËR**

Nr. 260, Datë 27.10, 2020

**PËR**

**“DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR.3, DATË 08.01.2016 “PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TRAJNIMIN E VIJUESHËM PROFESIONAL  
PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 1 të nenit 20, germës c) të nenit 23, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik,

**URDHËROJ:**

Në rregulloren që i bashkëlidhet urdhërit nr.3, datë 08.01.2016 bëhen disa ndryshime dhe një shtesë si më poshtë:

Në Kapitullin III “ Zbatimi i programit të trajnimit të vijueshëm profesional” shtohet neni 15 , me përmbajtje sa vijon :

Neni 15

Zhvillimi i trajnimeve online (në distancë)

1. Struktura përgjegjëse e harmonizimit të auditimit të brendshëm, bazuar në analizën e nevojave për trajnim të audituesve të brendshëm, kushtet dhe infrastrukturën e trajnimeve mund t’i paraqesë, Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm propozime për Programet /Temat e Trajnimit të cilat do të zhvillohen në platformën online si pjesë e Programit Vjetor të Trajnimit të Vijueshëm Profesional.
2. Pavarësisht formës së ofrimit të trajnimit, në klasë apo online procesi i trajnimeve duhet të sigurojë arritjen e objektivave të Programit Vjetor të Trajnimit të Vijueshëm Profesional të miratuar dhe zbatimin me efektivitet të këtij Programi.

Në rastet kur trajnimi do të ofrohet online kohëzgjatja e seancës ditore do të jetë 2(dy) orë,

3. Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm (KKAB), analizon dhe jep mendim për Programin e propozuar.
4. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pas reflektimit të rekomandimeve të KKAB-së, dërgon tek Ministri i Financave dhe Ekonomisë për miratim Programin dhe /apo ndryshimet përkatëse si dhe kalendarin e trajnimit të përshtatur sipas platformës online.
5. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm organizon, monitoron dhe siguron realizimin e Programit të Trajnimit online sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje, si dhe bën përshtatjen e informacionit dhe evidencave sipas të dhënave që siguron platforma online.

Pas shkronjës “i”, të pikës 3, të nenit 13, shtohen shkronjat “j” dhe “k” me përmbajtjen si më poshtë:

“j) Në rast se trajneri i zgjedhur nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, jep dorëheqjen nga procesi i zhvillimit të orëve të trajnimit të vijueshëm profesional, atëherë KKAB miraton trajnerin tjetër zëvendësues, i cili është renditur i pari në listën konkurruese, pas shpalljes të kandidatëve fitues të procesit të trajnimit.

“k) Në rast se nga lista e kandidatëve për trajnerë të shpallur fitues, nuk ka më kandidatë të tjerë të renditur më pas, atëherë Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, vendos të kërkojë, që prezantimi i temës së trajnerit të tërhequr nga procesi, të kryhet nga trajnerët e tjerë, bazuar në vlerësimin e aftësive profesionale, diplomën universitare, si dhe eksperiencën në mësimdhënie që ata zotërojnë. Në kushtet e mos përmbushjes së detyrimit, të parashikuar më sipër, KKAB kërkon zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së trajnerit të ri, brenda 10 ditëve kalendarike nga shpallja e njoftimit për aplikim.

Pas pikës 9, të nenit 17, shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10) Struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm, do të konsiderojë të vlefshme certifikatat apo dëshmitë e paraqitura nga audituesit e brendshëm në detyrë për trajnimet në fushën e auditimit të brendshëm, të ndjekura pranë institucioneve kombëtare, ndërkombëtare, si dhe projekteve të tjera që bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në funksion të plotësimit të detyrimit ligjor për trajnimin e vijueshëm profesional dhe të pasqyrimin të orëve të trajnimit në regjistrin e audituesve të brendshëm.

Në nenin 18, në pikën 1, togfjalëshi “6 orë trajnimi” zëvendësohet me togfjalëshin “1 ditë trajnimi”.

- a) Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik, dhe struktura përgjegjëse për shërbimet mbështetëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

